



*Shoqata e Gjykatësve të Kosovës
Udruženje Sudija Kosova
Kosovo Judges Association*

**PLANI STRATEGJIK
I SHOQATES SË GJYKATËSVE TË KOSOVES**

**STRATEŠKI PLAN
UDRUŽENJE SUDIJA KOSOVA**

**KOSOVO JUDGES ASSOCIATION
STRATEGIC PLAN**

2007-2009



Shoqata e Gjykatësve të Kosovës

Plani Strategjik

2007 2009

Prishtinë 20 Shtator

Afërdita Surroi dhe Kushtrim Islami nga Qendra Burimore për Trajnim dhe Avokim (ATRC) Ndhimuan në Hart imin e këtij Plani Strategjik

Shoqata e Gjykatësve të Kosovës
Kosovë



Shtator 2007

Re: Plani Strategjik 2007 – 2009 i Shoqates së Gjykatësve të Kosoves

Të Nderuar Gjykatës:

Në emër të Shoqates së Avokatëve Amerikan/Iniciativa për Sundimin e Ligjit (ABA) në Kosovë (ish ABA/CEELI), me kënaqësi ju prezantoj planin strategjik të zhvilluar nga Shoqata e Gjykatësve të Kosoves (SHGJK) si dhe Qendra Burimore për Trajnim dhe Avokim (ATRC). Personalisht dëshiroj të falenderoj njerëzit të cilët punuan në zhvillimin e këtij plani: z. Ymer Huruglica, zj. Elmaze Syka, zj. Mejreme Zekaj, z. Halil Dërguti, z. Ymer Hoxha, znj. Valdete Daka, z. Miodrag Paviq, zj. Sebahate Kurtishi, z. Rafet Haxhaj, z. Agim Metbala, z. Miftar Jasiqi, z. Zait Xhemali, z. Elez Hoxha, z. Gani Rexha, z. Zyhdi Haziri, z. Haxhi Dërguti, zj. Lumnije Krasniqi, zj. Kadrije Brajshori si dhe zj. Aferdita Surroi dhe z. Kushtrim Islami nga ATRC-ja.

Plani Strategjik i SHGJK-së është pjesë e angazhimeve tona të vazhdueshme për të avancuar shoqatat ligjore profesionale në Kosovë, kjo përfshinë Kodin e Etikës së Avokatëve së fundi të ndryshuar si dhe sistemin e ri disiplinor të Odës e Avokatëve të Kosovës OAK; si dhe tryezat e rumbullakëta të profilit të lartë Gjykatës-Avokat dhe Konferenca, gjatë së cilave janë identifikuar prioritete dhe kanë filluar të adresohen; si dhe është theksuar rëndësia e mbajtjes së femrave dhe minoriteteve në profesionin ligjor.

Ne besojmë se ky plan është aq i mirë sa njerëzit të cilët e implementojnë atë, dhe ky nuk është plan i vogël. Sfidat janë të mëdha për ta mbajtur këtë plan një dokument të gjallë nëpërmjet të përdorimit të tij të vazhdueshëm, referimit, rregullimit, dhe veprimtari të fokusuar. Duke e pajisur veten me këtë plan, ju do të jeni në gjendje t'i implementoni reformat ligjore dhe organizative që i keni identifikuar.

Ne jemi të kënaqur me bashkëpunimin tuaj, dhe shpresojmë të punojmë së bashku në të ardhmen. Nëse keni ndonjë koment apo pyetje mos hezitoni të na kontaktoni. Ju urojmë gjitha të mirat në implementimin e planit tuaj.

Sinqerisht,

David Sip, Drejtor,
ABA Iniciativa për Sundimin e Ligjit – Kosovë



Përmbajtja	Faqe
Informatë Parathënie dhe Biografi.....	4
Mandati, Vlerat, dhe Parimet e Shoqatës.....	7
Misioni, Vizioni, dhe Qëllimi i Shoqatës.....	8
Identifikimi i Problemeve dhe Analizë.....	9
Objektivat Bazuar në Problemet e Identifikuara.....	11
Aktivitetet e Bazuara në Problemet e Identifikuara dhe Solucionet e Propozuara.....	14
Anët e Forta të Shoqatës.....	16



Parathënie

Me qëllim të krijimit të një pushteti gjyqësor, të pavarur dhe efikas, është e domosdoshme që të krijohën kushtet për funksionimin e tij. Edhe pse në periudhën e pasluftës, kushtet për punë të gjykatësve ishin nën çdo nivel, tani ato kanë filluar të përmirësohen. Transferimi i kompetencave në lëminë e drejtësisë nga UNMIK-u në organet vendore, që rezultoi në krijimin e Ministrisë së Drejtësisë në kuadër të Institucioneve të Përkohshme të Vetë-Qeverisjes (IPVQ) është një tregues se sistemi gjyqësor ka shënuar ngritje dhe është duke u avancuar në drejtimin e duhur. Në veçanti, krijimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe roli i tij si organ i pavarur dhe i një rëndësie të veçantë në menaxhimin dhe kontrollin e sistemit gjyqësor paraqet një bazë shumë të mirë për krijimin e një sistemi gjyqësor të Kosovës, i cili do të ishte i pavarur, kompetent dhe profesional. Gjithashtu, kyçja e një nu mri të konsiderueshëm të pjesëtarëve të komuniteteve etnike të Kosovës në sistemin gjyqësor të Kosovës, në veçanti të komunitetit serb, është një e arritur e rëndësishme në drejtim të krijimit të një gjyqësori i cili përveç kompetencës, pavarësisë dhe profesionalitetit do të ishte edhe multietnik.

Shoqata e Gjykatësve të Kosovës ka luajtur një rol të rëndësishëm në arritjen e të gjitha këtyre rezultateve. Një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve, të organizuara me kontributin e vet SHGJK-së, si dhe me ndihmën e organizatave partnere, ka ndikuar që kontributi i SHGJK-së në këtë drejtim të jetë i një niveli të tillë. Nga të gjitha këto aktivitete do të veçoheshin disa që kanë pasur ndikimin më të theksuar.

Hyrje

Shoqata e Gjykatësve të Kosovës (SHGJK) është një shoqatë, vullnetare jo-qeveritare e gjykatësve aktiv të Kosovës e themeluar në Maj të vitit 2001. SHGJK-ja e ka Këshillin Drejtues prej 9 anëtarëve të përbërë nga gjykatës që përfaqësojnë të gjitha nivelet e gjyqësorit, dhe nga të gjitha regjionet e Kosovës. Një pozitë e Këshillit Drejtues të SHGJK-së është e rezervuar për një gjykatës nga komuniteti Serb dhe një tjetër pozitë për një gjykatës ndërkombëtar. SHGJK ka pesë degë, dhe secila degë ka delegatët e tyre të cilët votojnë për anëtarët e këshillit drejtues me mandate katër vjet. Secila degë mbajnë takimet e tyre dhe secila degë e ka kuvendin e saj dhe anëtarinë.

Komitetet të cilat ekzistojnë në SHGJK janë: komiteti për mbledhjen e fondeve; praktikant; resurse njerëzore; disiplinor; seminare dhe konferenca; komiteti për çështje administrative; e drejtë penale; e drejtë civile. Këto dy të fundit janë për ekspertët të cilët mund të hartojnë ligje dhe ose të komentojnë ligje. Gjithashtu është edhe këshilli redaktues që publikon Buletinin. Shumica e këtyre komiteteve takohen vetëm në raste ad hoc pra kur është e domosdoshme.

Misioni i SHGJK-së është i fokusuar “në mbrojtje dhe ngritje të interesave të gjykatësve si dhe avancimi i sistemit gjyqësor nëpërmjet ndërtimit të një sistemi gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm të bazuar në sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut” . SHGJK-ja është e fokusuar në arsimim gjyqësor dhe zhvillim profesional të anëtarëve të saj.



Për një qëllim të tillë përfaqësues të shoqates kanë marrë pjesë në Konferencën Regionale të Kosovës, gjithashtu në konferencën Shoqatat Gjyqësore për Planifikim Strategjik të Maqedonisë dhe Malit të Zi, financuar nga Shoqata e Avokatëve Amerikan/Iniciativa për Sundimin e Ligjit (ABA-ish ABA/CEELI), pra në Shkup, Maqedoni në Mars të vitit 2002. Si rezultat i kësaj konference organizata është përfshirë më fort në procesin e hartimit të planit të tyre të parë strategjik dhe në implementimin e aktiviteteve të tyre në praktikë më me efikasitet.

Për më shumë SHGJK-ja në bashkëpunim me ABA-në dhe Institutin Gjyqësor të Kosovës (IGJK) ka financuar diskutime- tryeza të rrumbullakëta të një pas njëshme me gjykatës Kosovar që kishin marrë pjesë në vizita studimore në vende të ndryshme të Evropës dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. SHGJK-ja gjithashtu ka ndjekur aktivitete të avokimit në lidhje me emërimet gjyqësore nga organizatat ndërkombëtare (UNMIK); përmirësim të kushteve të personelit gjyqësor dhe siguria e gjykatësve, këtë e ka bërë nëpërmjet komunikatave për media që u publikuan në gazetën kryesore ditore të Kosovës, siç janë Koha Ditore dhe Bota Sot kjo pra në fillim të vitit 2003.

SHGJK-ja punësoi anëtarin e parë të personelit, një administratore – Zonjusha. Kadrije Brajshori në vitin 2003, dhe kompletoi një ABA/RIBA vlerësim në vitin 2005.

SHGJK-ja ka mbledhur një numër modest të buletineve dhe gazetave për një bibliotekë profesionale për gjykatës në Kosovë; ka zbatuar një Program Gjyqësorë për *Praktikant* të përkrahur nga ABA dhe USAID; dhe me ndihmë profesionale dhe financiare të ABA-së dhe USAID-së, Komitetit Finlandez për të Drejtat e Njeriut, Komitetit të Kryqit të Kuq dhe KFOS-i (SOROS), çdo tre muaj publikon Buletinin për të gjithë anëtarët dhe partnerët e SHGJK-së .

SHGJK-ja bashkëpunon ngusht dhe në mënyrë profesionale është e aktivizuar me Oden e Avokatëve të Kosovës. Pas ndjekjes së një iniciative të ABA-së dhe Z. Michael Greco, ish President i ABA-së, në vitin 2005, SHGJK-ja me sukses zbatoi një projekt të tryezave të rrumbullakëta me Avokatë dhe Gjykatës pra në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës. Si rezultat kishte diskutime nga këto tryeza të rrumbullakëta në lidhje me qështjet që shqetësojnë të dyja palët gjykatësit dhe avokatët në të gjitha pra pesë regjionet e Kosovës.

Ne fund të vitit 2006 SHGJK-ja me ndihmën e ABA-së, rekrutuan dhe punësuan Znj. Lumnije Krasniqi drejtoreshë ekzekutive. Qendra Burimore për Trajnim dhe Avokim (ATRC) organizoi një seminar për SHGJK-në mbi planifikimin strategjik, që rezultoi në hartimin e planit strategjik 3 vjeçar që është duke u rishikuar nga anëtarët e SHGJK-së. SHGJK-ja gjithashtu ka zhvilluar një draft plan për zhvillim të avokimit. Nën udhëheqësinë e drejtoreshës së tyre të re të emëruar, SHGJK-ja zhvilloi dhe dorëzoi propozim projekte Fondacionit për Shoqëri të Hapur dhe Qendrës Burimore për Trajnim dhe Avokim (ATRC) që të dyja këto projekte më pas u aprovuan.



Për më tepër në vitin 2007 SHGJK-ja në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës dhe sponsoruar nga Qendra Burimore për Trajnim dhe Avokim (ATRC), ishte përfshirë në projektin për avokim dhe anti-korrupcion. Si pjesë e këtij projekti, SHGJK-ja në bashkëpunim me partnerë tjerë ka mbajtur disa tryeza të rrumbullakëta në qendra të ndryshme të Kosovës, me pjesëmarrës gjykatës, avokat dhe prokurorë. Çka është me rëndësi këto tryeza kishin tërhequr vëmendjen e mediave në të dy anët pra duke u transmetuar në lajme dhe programe të drejtpërdrejta, ku përfaqësuesit e organizatave sponsoruese kanë diskutuar çështje që kanë të bëjnë me korrupsionin. Projekti është duke vazhduar.

SHGJK-ja punon ngusht me organizatat lokale dhe ndërkombëtare që kontribuojnë duke mbështetur sistemin gjyqësor dhe rolin e tij në shoqëri. Shumica e organizatave të rëndësishme që SHGJK-ja ka bashkëpunuar me to në projekte të ndryshme janë: Komiteti i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, Komiteti Finlandez për të Drejta të Njeriut, Fondacioni për Shoqëri të hapur, Qendra Burimore për Trajnim dhe Avokim (ATRC), si dhe me ABA-në – Agjencioni i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Ka një bashkëpunim të mirë në mes të SHGJK-së dhe ABA-së, dhe Qendres Nacionale për Gjykata Shtetërore NCSC dhe IGJK.



Mandatet, Vlerat, Parimet e Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës (SHGJK)

Mandatet e SHGJK-së:

a. Formale

Rregullorja e UNMIK-ut për regjistrimin e organizatave jo-qeveritare

Ligji mbi gjyaktat e rregullta

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

b. Jo formale

Përkrahja në reformimin e sistemit gjyqësor të Kosovës

Vlerat e SHGJK-së

Pavarësia

Paanëshmëria

Sundimi i Ligjit

Përmbajtja në Kodin e Etikës

Solidariteti në mes të Gjykatësve

Toleranca Etnike dhe Religjioze

Barazia e Gjykatësve

Pjesëmarrja Aktive në Shoqërinë Civile

Parimet e SHGJK-së

Grupet e Interesit:

Këshilli Gjyqësor

Ministria e Drejtësisë

Departamenti i Drejtësisë

Oda e Advokatëve të Kosovës

Shoqata e Prokurorëve të Kosovës

Shërbimi Policor i Kosovës SH.P.K

Shërbimi Doganor

Komisioni Legjislativ pranë Parlamentit të Kosovës

Mjetet e Informimit

Shoqata e Juristëve të Kosovës

Qendra Për Punë Sociale

Shërbimi Sprovues

Shërbimi për Mbrojtjen e Viktimave

Instituti i Mjekësisë Ligjore

Ombudspersoni

Instituti Gjyqësor i Kosovës

Qendra Juridike



Misioni, Vizioni, Qëllimet e SHGJK-së

Misioni i Shoqates së Gjykatësve të Kosovës (SHGJK): Ndërtimi i një sistemi gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm mbi bazën e sundimit të ligjit dhe respektimin e të drejtave të të gjithëve pa dallim kombi, feje, gjinie apo race.

Realizimit të këtij misioni do t'i kontribuoj ruajtja e integritetit të gjykatësve, efikasiteti i tyre në punë, ngritja e pozitës materiale dhe aftësi profesional, me qëllim që t'ju përshtatet sistemeve të avansuara gjyqësore të shoqërive demokratike.




Vizioni i SHGJK-së: Kosova shoqëri ku sundon ligji dhe e drejta, e integruar në progresin Evropian, me mundësi të barabarta për zhvillim personal të të gjithë individëve, të cilët i kontribuojnë zhvillimit të sistemit të qëndrueshëm juridik dhe shoqëror.





Qëllimet e SHGJK-së: Ndërtimi i një sistemi gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm.

- Të përmirësohet infrastruktura ligjore, të ngritet numri i gjyqtarëve me qëllim të aplikimit të standardeve kohore të përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor.
- Respektimi i Dispozitave Kushtetuese dhe Ligjore si vlera më të larta juridike.
- Të përcaktohen forma për informimin e publikut për procesin e zgjedhjes së çështjeve..
- Ngritja e sigurisë së gjyqtarëve dhe krijimi i kushteve për dëshmitarët mbrojtës.
- Përcaktimi i formave adekuate për vetëfinansim dhe ngritje të fondeve nga donatorët për nevoja të shoqatës.
- Ngritja e transparencës në gjykata dhe për proces ligjor.
- Përmirësimi në menagjimin e bugjetit financiar në gjykata







SHGJK - Identifikimi i Problemeve dhe Analizë







Objektivat e SHGJK-së Bazuar në Problemet e Identifikuara







Aktivitetet e SHGJK-së

Bazuar në Probelemt e Identifikuara dhe Solucionet e Propozuara

1. Objektiva: Krijimi i Infrastruktures Ligjore

Aktivitetet:

- Definimi dhe identifikimi i ekspertëve;
- Organizimi i tryezave të rrumbullakëta;
- Organizimi i takimeve, seminareve;
- Identifikimi i prioriteteve;
- Zhvillim të Avokimit;
- Themelimi dhe zhvillimi legjislativ i kontakteve me Parlamentin e Kosovës

2. Objektiva: Zvogëlimi i Rasteve të Grumbulluara

Aktivitetet:

- Identifikimi i nevojave të gjyqësorit;
- Rritja e numrit të gjykatësve në gjykata
- Analizim i caktimeve të lëndëve në gjykata
- Avokim dhe konferenca për shtyp me media;
- Fillimi i programit të ri për gjykatësit e rinj

3. Objektiva: Sigurimi i Mjeteve të Nevojshme Financiare

Aktivitetet:

- Kërkesë me shkrim për ngritjen e ndihmës financiare;
- Kërkesë me shkrim të kërkohet për zyrë të SHGJK-së;
- Zhvillimi i Propozimeve Financiare

4. Objektiva: Menagjimi Adekuat i Bugjetit

Aktivitetet:

- Përpilimi i listës për nevojat e gjyqësorit;
- Planifikimi i bugjetit për mesin e tremujorit;
- Organizimi i takimeve të përbashkëta



5. Objektiva: Avancimi Profesional i Gjykatësve

Aktivitetet:

Hartimi i programit një-vjeçar për trajnim;
Kontaktimi me IGJK-në dhe diskutimi i nevojave prioritare për trajnime;
Selektimi i ekspertëve për trajnim;
Organizim të vizitave studimore dhe shkëmbyese me kolegët

6. Objektiva: Ngritja e Shkallës së Sigurisë

Aktivitetet:

Vendosja e kontakteve me zyrtar të sigurimit të KGJK-së;
Zhvillimi i strategjive për mbrojtjen e gjykatësve në situata emergjente;
Kontaktimi me mekanizmat relevant për implementimin e planit të sigurisë

7. Objektiva: Luftimi i Korrupsionit

Aktivitetet:

Planifikimi strategjik i përbashkët i SHGJK-së dhe SHPPK-së në luftimin e Korrupsionit
Lobim për më shumë Kompetenca për Kryetarët e Gjykatave
Kontaktimi me KGJK-në në lidhje me hartimin e dokumenteve dhe ndarjen e Kompetencave

8. Objektiva: Avokim dhe Lobim/Ngritje e Vetëdijës së Publikut

Aktivitetet:

Zhvillimi i TV dhe Radio programeve dhe intervistave për shtyp;
Grupi punues i SHGJK-së aktiv në zhvillimin e takimeve të rregullta;
Zhvillimi i tryezave të rumbullakëta me gjykatës të të gjitha niveleve



Anët e forta të SHGJK-së

- **Menaxhimi i mirë i shoqatës**
- **Koordinim të mirë me stafin dhe bordin**
- **Kooperim të mirë me degët e shoqatës**
- **Involvimi i madh i anëtarëve të shoqatës në punët e shoqatës**
- **Transparenca**
- **Involvimi i kënaqshëm i minoriteteve**
- **Involvimi i gjykatësve ndërkombëtar**
- **Bashkëpunim të mirë me shoqata të tjera dhe me odën e avokatëve**
- **Bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe lokale:**

Bashkëpunimet:

Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)
Shoqata e Avokateve Amerikan (ABA)/ Iniciativa për Sundimin e Ligjit
Qendra Kombëtare për Gjykatat Shtetërore (NCSC)
Komiteti i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar (ICRC)
Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Europian (OSCE)
Këshilli Finlandez për të Drejtat e Njeriut
Shoqata e Gjykatësve të Maqedonisë
Oda e Avokatëve të Kosovës
Shoqata e Prokurorëve Publik të Kosovës (SHPPK)

- **Publikimi i buletinit**

